



SË BASHKU PËR ARSIMIN

KOHA PËR TË MARRË PËRGJEGJËSI

21 Prill 2017, ora 10:30

COD-Kryeministri

Të nderuar Miq dhe Kolegë,

Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, ka kënaqësinë t'ju ftojë ditën e Premte, 21 Prill, ora 10:30 në mjediset e Qendrës për Hapësirë dhe Dialog (COD), Kryeministri, në aktivitetin **“Së bashku për Arsimin! Koha për të marrë përgjegjësi!”** që organizohet në kuadër të Javës Globale për Arsimin 2017.

Përqindja e ulët e PBB që Shqipëria investon për arsimin, është nën standardin minimal ndërkombëtar dhe atë rajonal, dhe kjo bie ndesh me detyrimin e shtetit për marrjen e masave të duhura në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm për ofrimin e arsimit publik të barabartë, cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Çdo vit përgjatë “Javës Globale të Arsimit”, Fushata Globale e Arsimit ngre zërin për garantimin e të drejtës së çdo fëmije për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës. Në moton **“Së bashku për Arsimin! Koha për të marrë përgjegjësi!”** fushata e Javës Globale për arsimin tërheq vëmendjen e vendimmarrësve në mbarë botën për të përmbushur premtimet e mara me firmosjen e Axhendës për realizim të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm.

Të pranishëm në këtë aktivitet do të jenë përfaqësues të MAS, përfaqësues të OSHC-ve, organizatave ndërkombëtare, bota akademike, mësues, prindër, nxënës të shkollave 9-vjecare dhe të mesme, media etj.

Jeni të lutur të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj brenda datës 20 Prill 2017, Ora 14:00 në adresën linda.pino@crca.al

Axhenda do t'ju dergohet së shpejti



GLOBAL CAMPAIGN FOR
EDUCATION

www.campaignforeducation.org

